

Trajnimet për Trajnues

Duke u bazuar në Programin Kornizë 2021-2022, objektivë dhe fokus i Akademisë së Drejtësisë do të jeneë edhe trajnime për trajnues me theks te avancimi i metodologjisë trajnuese bashkëkohore, marrë parasysh rendësinë e tyre në zbatimin dhe realizmin e Programeve Trajnuese.

Në vazhdën e kësaj, në kuadër të bashkëpunimit me partner ndërkombëtar, përkatësisht projektin e KE për përf forcimin e lirisë së shprehjes – JUFREX do të organizohet Trajnimi i trajnerëve për lirinë e shprehjes. Pjesëmarrësit në TiT do të jenë gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë. Aktiviteti do të mbështetet nga ekspertët ndërkombëtarë të cilët do të përqendrohen në standardet ndërkombëtare në lidhje me Lirinë e shprehjes dhe metodologjinë e të mësuarit për të rritur, të cilat do të përdoren nga trajnerët e ardhshëm gjatë trajnimeve vijuese. Dita e fundit e trajnimit do të përqendrohet në platformën HELP dhe në dy kurse të ofruara në të (Kursi HELP mbi Lirinë e Shprehjes dhe Kursi HELP mbi Sigurinë e Gazetarëve). Koha që të dyja këto tema të trajtohen në një ditë të TiT do të ndahet në mënyrë të barabartë.

Po ashtu në kuadër bashkëpunimit me projektin e KE, Arikulli 3 i KEDNJ për parandalimin e torturës, Akademia e Drejtësisë do të organizoj trajnimin për trajnues për Nenin 3 të KEDNJ. Trajnime për trajnues do të ketë edhe për fushën e Drejtësisë Komerciale, në bashkëpunim me USAID/CHECCHI and Company Consulting.

Gjithashtu, vlen të theksohet së Akademia në bashkëpunim me OPDAT është në proces të hartimit të Programit të Përhershëm për Trajnues. Për shkak të natyrës së programit dhe infrastrukturës ligjore të Akademisë së Drejtësisë - i cili duhet të rishikohet, ky proces pritet të fillojë gjatë vitit 2021.